



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Vlerësimit Institucional të
Kolegjit Profesional të Tiranës**

Prill 2017

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1. Znj. Penny Renwick

Kryetare



2. Z. Grant Horsburgh

Anëtar



3. Dr. Gjergj Thomai

Anëtar



Data: Prill 2017

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	3
Konteksti i këtij vlerësimi	4
Raport i përmbledhur	5
Përmbledhje e gjetjeve.....	9
Raporti i detajuar.....	11
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	11
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	14
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	18
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	22
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	25
Lista e dokumenteve	29

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet për përmirësime (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre.

Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve të ndërmarra dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, përfshirë gjykimin se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Kolegji Profesional i Tiranës u licencua në vitin 2015 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, si institucion privat i arsimit të lartë, për të ofruar programe studimi jouniversitare, profesionale dhe me kohë të plotë pas arsimit të mesëm, në drejtimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, mekatronikës, teknologjisë së ajrimit dhe kondicionimit, gjeodezisë dhe teknologjisë së ndërtimit. Kërkimi i tregut ka nxjerr në pah hendekun e dukshëm në arsimin profesional, veçanërisht në drejtimet teknike dhe inxhinierike, dhe misioni i Kolegjit Profesional të Tiranës është t'u ofrojë të diplomuarve aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për punësim ose mundësinë për të vazhduar kolegjin. Kolegji Profesional i Tiranës synon të jetë ofrues i rëndësishëm i arsimit profesional në Shqipëri, duke qenë një urë lidhëse ndërmjet arsimit akademik dhe formimit profesional.

Në shtator të vitit 2015, në Kolegjin Profesional të Tiranës u regjistrua një grup prej 69 studentësh në drejtimet e elektronikës, elektromekanikës, teknologjisë së automjeteve, dhe teknologjisë së ajrimit dhe kondicionimit. Vitin pasardhës u shtuan edhe pesë disiplina të reja, që ishin: teknologjia e informacionit dhe komunikimit, elektronika, database dhe web design, mekatronika dhe gjeodezia. Në vitin 2017, lista në portofolin akademik u shtua me teknologjinë e instalimeve elektrike.

Gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, Kolegji kishte Departamentin e Elektromekanikës dhe Departamentin e Sistemeve të Aplikuara, të mbështetura nga koordinatorët akademikë.

Në këtë kolegji ndodhen një sërë laboratorësh dhe punishtesh, si dhe po punohet për hapjen e një biblioteke. Zyra e Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve ofron shërbime për pranimet, veprimtaritë sociale të studentëve, dhe zhvillimin e karrierës. Kolegji ka 23 pedagogë me kohë të plotë (3 pedagogë dhe pedagogë) dhe 26 pedagogë me kohë të pjeshme (14 pedagogë dhe 12 pedagogë). Gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, kolegji kishte 237 studentë (26 studente dhe 247 studentë) të regjistruar në 9 programet dyvjeçare, në fund të të cilave pajisen me diplomë profesionale.

Raport i përmbledhur

Kolegji Profesional i Tiranës (Kolegji; KPT) është institucion privat, godinat e të cilit ndodhen në qendër të qytetit, dhe ushtron veprimtarinë e tij që prej vitit 2015. Gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, KPT-ja kishte 273 studentë të regjistruar në 9 programet dyvjeçare, për pajisur në fund me diplomë profesionale. Kolegji ka 23 pedagogë me kohë të plotë dhe 26 pedagogë me kohë të pjesshme për të dy departamentet: Departamentin e Elektromekanikës dhe Departamentin e Sistemeve të Aplikuara.

Një grup nga kolegji hartoi raportin e vetëvlerësimit, në hartimin e të cilit u angazhuan drejtues të nivelit të lartë, stafi akademik dhe ai mbështetës, dhe një përfaqësues e studentëve. Projektraportet iu shpërndanë një audience më të gjerë në institucion përpara përfundimit dhe miratimit të raportit përfundimtar nga Rektori.

Vizita u realizua gjatë dy ditëve, konkretisht më 27 dhe 28 prill të vitit 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të nivelit të lartë për arsimin e lartë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe nga një anëtar me përvojë në arsimin e lartë, pjesë e personelit të institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një person të caktuar për mbajtjen e shënimeve nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara kryerjes së vizitës së vlerësimit, që më pas u plotësua me dokumentet shtesë të kërkuara. Gama e gjerë informacionit mbështetës, të ofruara nga Kolegji, e ndihmoi grupin të njihet me strukturën, politikën dhe procedurat e menaxhimit, dhe me mënyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë profesionale të ndërmarrë nga institucioni. Dokumentet përfshinin Statutin e Kolegjit, Rregulloret Akadematike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën të marrëveshjeve me jashtë, shembuj të informacionit për programin dhe dokumentacionin e mbledhjeve vendimmarrëse.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtues të nivelit të lartë, studentë, pedagogë, stafin mbështetës dhe administrativ, si dhe me partnerë dhe punëdhënës të jashtëm gjatë vizitës së vlerësimit. Diskutimi u përqendrua në sqarimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Gjatë takimeve u mbajtën shënime. Si pjesë e turit në ambientet e Kolegjit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët, laboratorët dhe punishtet, dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk përcaktoi veprime të ndërmarrë. Qeverisja e KPT-së dhe kuadrot e tij rregullatore janë në përputhje me kërkesat e legjislativës për institucionet e arsimit të lartë. Statuti i Kolegjit përcakton misionin e tij, organizimin e brendshëm dhe organet drejtuese. Marrëveshjet për menaxhimin, administrimin dhe vendimmarrjen e kolegjit i përmbahen kërkesave ligjore, dhe stafi i të gjitha niveleve është i njohur me to. Senati Akadematik ka ngritur një grup pune, detyra e të cilit është të bëjë propozime për ndryshime në Statut dhe rregulloret, në zbatim të ligjit të ri për arsimin e lartë. Zhvillimi social dhe ekonomik i Shqipërisë është një parim themelor i Strategjisë së Zhvillimit të Kolegjit 2015-2020, i cili ka krijuar një rrjet partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, duke përfshirë bizneset vendore, organet publike dhe institucionet e arsimit të lartë. Kolegji është i regjistruar pranë institucioneve përkatëse evropiane, megjithëse statuti aktual i Kolegjit nuk e lejon atë të përfitojë nga programet evropiane. Njësia e Sigurimit të Cilësisë është përgjegjëse për vetëvlerësimin e veprimtarive akademike dhe administrative, dhe për këtë arsye ka kryer një sërë auditimesh dhe projektesh monitorimi, për t'u siguruar që zbatimi të jetë i efektshëm. Krahas kësaj, në veprimtarinë e monitorimit të brendshëm dhe vetëvlerësimit marrin pjesë konsulentë të jashtëm akademikë dhe konsulentë për lëndë specifike.

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë dhe asnjë dobësi ose veprime tashmë në progres. KPT-ja, në lidhje me burimet njerëzore ndjek politika të qarta dhe të hapura, që mbulojnë rekrutimin dhe punësimin e stafit dhe përmbushin kërkesat rregullatore. Politikat dhe procedurat mbështesin dhe udhëheqin në mënyrë të efektshme rekrutimin e stafit të kualifikuar, si me kohë të plotë, ashtu edhe me kohë të pjesshme, për të përmbushur kërkesat akademike dhe administrative të kolegjit. KPT-ja ka hartuar procedura të përshtatshme për efektshmërinë e stafit të tij akademik. Procesi i vlerësimit bazohet si në vlerësimin e mënyrës së mësimdhënies gjatë vitit akademik nga menaxherët e linjës, ashtu edhe në analizën e pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Kolegji i kushton shumë rëndësi zhvillimit profesional të stafit akademik, dhe për këtë arsye konsulentët e jashtëm të kompanisë, që ka ofruar pajisjet për laboratorët dhe punishtet, zhvillojnë seanca trajnimi. Kolegji ka krijuar një sistem të efektshëm për menaxhimin financiar, dhe gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor zbatohen ligji për arsimin e lartë dhe rregulloret e kolegjit. KPT-ja ka një sistem të integruar informacioni të mbështetur në Politikat e Komunikimit. Kolegji ka blerë një paketë softuerësh, për të menaxhuar të dhënat për studentët, që përfshin procesin e pranimit, materialet e mësimdhënies dhe mësimnxënies, librave elektronikë, oraret e mësimdhënies, informacionin për vlerësimin dhe disa informacione të tjera lidhur me historikun e tyre në kolegji. Niveli i integritetit të sistemeve të informacionit të kolegjit, i arritur nëpërmjet kësaj pakete softuerësh, dhe që akseson lehtësisht një mori informacionesh në një platformë të sigurt teknologjike, konsiderohet si karakteristikë e praktikës së mirë. Infrastruktura ekzistuese, stafi akademik me përvojë dhe i kualifikuar, laboratorët e pajisur me mjete moderne, dhe lidhjet e përshtatshme me tregun e punës garantojnë që të gjitha veprimtaritë e kolegjit të kryhen në mënyrë të efektshme. Kolegji ka zhvilluar një ndjenjë komuniteti dhe integrimi midis stafit dhe studentëve të tij. Studentët i vlerësojnë shumë përfitimet që kanë nga mbulimi i plotë i sigurimeve shëndetësore, dhe ekspertët e konsiderojnë këtë si karakteristikë të praktikës së mirë.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi veprime tashmë në progres. KPT-ja ka një mision të qartë për sa i përket ofrimit të arsimit dhe formimit profesional, për të përmbushur nevojat e punëdhënësve dhe ekonomisë në Shqipëri, dhe aktualisht ofron nëntë programe të licencuara dyvjeçare me kohë të plotë, dhe në fund pajisen me një diplomë profesionale. Pranimet menaxhohen nga Zyra e Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve në përputhje me politikat e Kolegjit për pranimet dhe komunikimin. Senati mbikëqyr programet e studimit, dhe njësitë dhe kreditet për secilin program përcaktohen qartë dhe janë të kuptueshme nga studentët. Kurrikulat përfshijnë një ndërthurje të teorisë dhe praktikës, duke përfshirë të nxënit në laborator, dhe studentët janë të mendimit se ekuilibri midis teorisë dhe praktikës është i përshtatshëm. Kurrikulat zhvillojnë aftësi teknike dhe profesionale, duke zbatuar teorinë me anë të praktikës dhe simulimit, dhe duke i vënë ato në praktikë në laboratorë e më pas në punishte, dhe duke i përforcuar ato në institucionet, ku zhvillojnë praktikën profesionale. Studentët nxiten të marrin pjesë në një sërë veprimtarish aftësimi, si: Klubi i Novacionit, printimi në 3D, dhe Drone. Ata gjithashtu kanë mundësinë të punojnë direkt me sektorin e industrisë në një sërë projektesh. Kolegji ka punësuar numrin e duhur të stafit për të ofruar programet e tij, duke punësuar 23 pedagogë me kohë të plotë dhe 11 pedagogë me kohë të pjesshme, nga të cilët disa janë staf me përvojë në sektorin e industrisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron praktikë të mirë ofrimin e kurrikulave novatore mbështetur në praktikë, që përmbush nevojat e industrisë dhe të diplomuarve.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjeti një karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi veprime tashmë në progres. Ka mekanizma për të menaxhuar cilësinë dhe standardet e mësimdhënies, të cilët sigurojnë përmbushjen e

standardeve të cilësisë. Departamentet janë përgjegjëse për menaxhimin efikas të programeve, duke hartuar syllabuse, oraret e semestrit, dhe pyetjet e provimeve. Programet e studimit përmirësohen vazhdimisht nëpërmjet një procesi rishikimi vjetor, i cili përfshin rishikimet e secilit program, duke u bazuar te studimi i tregut të punës. Kolegji ka shumë laboratorë dhe punishte të cilësisë së lartë, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron praktikë të mirë zbatimin e kësaj kurrikule. Studentët gjithashtu zhvillojnë praktikën profesionale. Kërkesat dhe rregulloret e vlerësimit përcaktohen në Statut dhe rregulloret akademike, në përputhje me standardet e cilësisë. Procedurat që ndjek KPT-ja për kryerjen e vlerësimit dhe monitorimit të proceseve të mësimdhënies, janë në përputhje me Statutin e saj dhe zbatohen nën kujdesin e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë. Këto procedura përfshijnë: vlerësimin e studentëve, vlerësimin e mësimdhënies, pyetësorë, si dhe analizën e performancës së studentëve. Gjatë vlerësimit të jashtëm, studentët pranuan se ndryshimet dhe përmirësimet në ofrimin e mësimdhënies dhe mësimdhënies pasqyronin feedback-un që kishin dhënë nëpër pyetësorë. Grupi i sigurimit të cilësisë vëzhgon mësimdhënien dhe përgatit një raport vlerësimi në bazë të informacionit të mbledhur, anketimeve, vëzhgimit nga grupi në grup dhe vëzhgimit nga përgjegjësi i departamentit. Raportet më pas shqyrtohen nga përgjegjësi i departamentit përkatës, i cili përgatit një përmbledhje të vlerësimit dhe përcakton objektivat për vitin akademik pasardhës. KPT-ja ofron kualifikime të nivelit të pestë, duke u përqendruar në përgatitjen e profesionistëve dhe specialistëve, me titullin "Teknik". Për këtë arsye, kërkimi shkencor i mirëfilltë nuk është pjesë e politikave. Megjithatë, kolegji i përkushtohet kërkimit kundrejt objektivave të tij, të përcaktuara në Statut, dhe kërkimi dhe përkushtimi ndaj rritjes së kapacitetit të stafit janë pjesë e nismave të ndërmarra nga marrëveshjet dypalëshe me IAL-të e tjera.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë dhe nuk pohoi veprime tashmë në progres. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka dhënë tre rekomandime, që kolegji t'i marrë parasysh për ta siguruar më tej cilësinë dhe përmbushjen e standardeve të programeve të tij, me qëllim përmirësimin e përvojës së nxënies së studentëve të tij. Pranimi i studentëve në programet e studimit menaxhohet në përputhje me rregulloret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe në Statutin dhe rregulloret e kolegjit. Zyra e Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve koordinon zyrat e marketingut dhe komunikimit në përputhje me Politikën e Komunikimit. Studentëve iu është ofruar një manual gjithëpërfshirës dhe ata i pohuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se kanë marrë informacione të hollësishme për syllabusin. Aktualisht, godinat nuk janë të aksesueshme për studentët me aftësi të kufizuara. Aksesi i kufizuar në të gjitha godinat e mësimdhënies konsiderohet si dobësi, dhe rrjedhimisht rekomandohet që kolegji të marrë masa për ta bërë kampusin plotësisht të aksesueshëm për studentët me aftësi të kufizuara.

Biblioteka është në hapat e parë të zhvillimit, dhe megjithëse kolegji po ndërmerr hapa për ta përmirësuar këtë gjë, nuk ka ende një plan të qartë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi literaturën aktuale në bibliotekë, që iu ofrohet studentëve në format të shtypur dhe elektronik, si dobësi, dhe rekomandoi që kolegji të hartojë dhe të zbatojë një plan për zhvillimin e bibliotekës, për të ofruar literaturën e mjaftueshme në format të shtypur dhe elektronik. Studentëve iu ofrohet mjaftueshëm mbështetje. Tutorimi dhe këshillimi akademik përcaktohen në rregullore, dhe intraneti ofron informacione të hollësishme të programeve, si edhe shënime të leksioneve dhe materiale të kurseve. Këshilli Studentor i formuar së fundmi ofron feedback në emër të trupës studentore. Megjithatë, ai nuk ka akses në burimet e tij financiare dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron dobësi këtë gjë, dhe rekomandon që kolegji t'ia alokojë burimet financiare. KPT-ja ka një mision të qartë për ofrimin e programeve profesionale, për të përmbushur nevojat e punëdhënësve dhe të ekonomisë. Megjithëse, asnjë student nuk është diplomuar ende, studentët dhe punëdhënësit kanë besim se të diplomuarit do të kenë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për t'u punësuar menjëherë. Aktualisht, Zyra e Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve luan rol kyç në

mbështetjen e studentëve për të gjetur punë dhe kolegji ka plane për hapjen e Zyrës së Karrierës në një të ardhme të afërt.

Në arritjen e këtyre gjykimeve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi katër karakteristika të praktikës së mirë, të cilat kolegji mund t'i shfrytëzojë dhe zhvillojë më tej, si dhe t'i shpërndajë në të gjithë sektorin e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha dy rekomandime, që kolegji t'i marrë parasysh për ta siguruar më tej cilësinë dhe për të përmbushur standardet e programeve të tij, si dhe për të përmirësuar përvojën e nxënies së studentëve të tij.

KPT-ja ndërmori vetëvlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm verifikoi nivelin e angazhimit të kolegjit në procesin dhe bashkëpunimin e tij me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga Znj. Penny Renwick (Kryetar), Dr. Gjergj Thomai dhe Z. Grant Horsburgh (Anëtarë).

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se Standardet e Cilësisë janë përmbushur plotësisht në katër fusha dhe kryesisht në një fushë.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- kontratat e sigurimit të plotë të dëmshpërblimit, që iu ofrohen të gjithë studentëve të regjistruar me mbulim të plotë të rasteve të aksidenteve, kujdesit shëndetësor dhe atij diagnostikues, dhe e gjithë mbështetja mjekësore e nevojshme (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.2**)
- niveli i integritit të sistemeve të informacionit të kolegjit i arritur, nëpërmjet paketës së softuerëve, që iu mundëson stafit dhe studentëve akses në një sërë informacionesh në një platformë të sigurt teknologjike (pika 2.5; **Kapitulli III Standardi VII.1**).
- ofrimi i kurrikulave novatore mbështetur në praktikë, që përmbushin nevojat e sektorit të industrisë dhe të diplomuarve (pika 3.12; **Kapitulli I Standardi I.12**)
- laboratorë dhe punishte cilësore, për ta mbështetur ofrimin e kurrikulës (pika 4.1; **Kapitulli I Standardi II.1**).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- akses i kufizuar në ambientet e mësimdhënies për studentët me aftësi të kufizuara (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.4**)
- literatura aktuale në bibliotekë që iu ofrohet studentëve në format të shtypur dhe elektronik (pika 5.5; **Kapitulli I Standardi III.5**)
- Këshilli Studentor nuk ka akses në burimet e tij financiare (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm për vëmendje të menjëhershme:

- të hartohet dhe të zbatohet një plan për zhvillimin e bibliotekës, për të siguruar ofrimin e literaturës së mjaftueshme në format të shtypur dhe elektronik (pika 5.5; **Kapitulli I Standardi III.5**).

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet të tjera:

- kampusi të bëhet plotësisht i aksesueshëm nga studentët me aftësi të kufizuara (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.4**)
- Këshillit Studentor t'i alokohen burime financiare (Pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht.**
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht.**

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Kolegjin Profesional të Tiranës, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përbushur plotësisht.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Qeverisja e KPT-së dhe kuadrot e tij rregullatore janë hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit për institucionet e arsimit të lartë. **[RVV fq.8; 2; 6; 7; 8; 36; 38; 40; AE1]**Statuti përcakton misionin e kolegjit, dhe strukturat e organizimit dhe menaxhimit të brendshëm. **[2]** Përgjegjësitë individuale dhe zyrtare të bordit dhe këshillit janë përcaktuar gjithashtu në rregulloret e kolegjit. **[6]** Kolegji e amendon dhe e ndryshon Statutin dhe rregulloret e tij sipas kërkesave. **[AE2; AE3; AE24]** Senati Akademik ka ngritur një grup pune që bën propozime, për të ndryshuar Statutin dhe rregulloret, duke u bazuar te dispozitat e ligjit të ri për arsimin e lartë. **[M3][Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.2 Kolegji është i organizuar për të siguruar menaxhim efikas në përputhje me kërkesat e Ministrisë.**[RVV fq.9-10; 2; 6; 10]** Rrjedha e informacionit nga departamentet te Senati, dhe shpallja e vendimeve të Senatit për studentët dhe stafin kryen në mënyrë të efektshme. Rregullimet për menaxhimin dhe administrimin e kolegjit, dhe vendimmarrjen e tij përmbushin kërkesat ligjore, si dhe zbatohen dhe janë të kuptueshme nga stafi i të gjitha niveleve. Ndarja e përgjegjësive menaxhuese është e dukshme lidhur me çështje akademike dhe administrative. Çështjet akademike mbikëqyren nga Senati Akademik, ndërsa çështjet administrative nga Asambleja e Përgjithshme. **[RVV fq.9-10; 12; AE3; AE5; AE5; AE7; M2; M3; M4][Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.3 Bordet dhe këshillat e kolegjit mbledhen rregullisht dhe informacioni për pikat e axhendës i vihet paraprakisht në dispozicion të të gjithë stafit në mënyrë elektronike. **[RVV fq.10; 11; AE10; M3]** Rregullimet për operimin e këshillave dhe bordeve vendimmarrës janë të kuptueshme nga stafi dhe studentët. Studentët dhe stafi u shprehën se çështjet e propozuara nga ata marrin vëmendjen e duhur, nëpërmjet debateve konstruktive dhe kolegjinale të bordeve dhe këshillave, dhe rezultatet iu bëhen të ditura edhe atyre. **[M4; M5]** Përgjegjësit e departamenteve janë përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e vendimeve të miratuara, dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë monitoron dhe vlerëson efektshmërinë e zbatimit. **[RVV fq.10; 13; M2][Kapitulli III Standardi I.3]**
- 1.4 KPT-ja sigurohet që kufijtë e autonomisë së tij të respektohen dhe që ai ta ushtrojë veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi. **[RVV, fq.10-11]** Vetëqeverisja është e dukshme në njësitë organizative akademike dhe administrative, në veprimtaritë e mësimdhënies dhe ato shkencore, dhe në çështjet financiare dhe administrative. Njësia e Sigurimit të Cilësisë është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe vetëvlerësimin e menaxhimit të veprimtarive akademike dhe administrative, si dhe ka kryer auditime dhe ka zbatuar projekte monitorimi, për t'u siguruar që zbatimi është i efektshëm. **[RVV fq.10-11; 13; 15; AE25; AE35; M2; M3; M4]** Konsulentë të jashtëm akademikë dhe konsulentë për lëndë specifike marrin pjesë në veprimtaritë e monitorimit të brendshëm dhe vetëvlerësimit. **[RVV fq.10-11; 16; M2; M3; M4]**Pavarësisht se statusi aktual i kolegjit nuk e lejon të përfitojë nga programet evropiane, kolegji është i regjistruar pranë institucioneve përkatëse evropiane. **[RVV fq.11; 16; M2; M3; M4] [Kapitulli III Standardi I.4]**
- 1.5 Kolegji ka një strategji të përshtatshme zhvillimi për periudhën 2015-2020, e cila është miratuar nga Senati. **[RVV fq.11; 5; 17]** Strategjia merr parasysh vizionin, misionin, përparësitë, dhe objektivat e kolegjit. Procesi i hartimit të saj përfshinte mbledhjen e informacioneve nga këshillat e departamenteve dhe Këshilli Studentor. **[RVV fq.11; M2; M3][Kapitulli III Standardi I.5]**

- 1.6 Raporti vjetor i hartuar në përputhje me kërkesat ligjore, që i paraqitet Ministrisë, mbulon një sërë temash akademike dhe administrative. Procesi i hartimit përbëhet nga raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të vetëvlerësimit, dhe nga veprimtaritë e programeve të studimit, të përgatitura rregullisht nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë. **[RVV fq.11-12; 8; 23; 24; M2; M3]** Raporti përfundimtar iu vihet në dispozicion bordeve dhe komiteteve përkatëse në mbarë kolegjin, dhe stafi dhe studentët kanë akses, nëpërmjet faqes së internetit të kolegjit. **[M2; M3; M4][Kapitulli III Standardi I.6]**
- 1.7 Departamentet e kolegjit janë organizuar në përputhje me kërkesat ligjore për institucionet private të arsimit të lartë. **[RVV fq.12-13; 2; M1; M2]** Strukturat menaxhuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike; stafi akademik është i kualifikuar dhe ka autonomi e liri akademike në të gjitha veprimtaritë akademike. Kolegji ka faqen e tij zyrtare dhe ofron programe studimi profesionale, të hartuara për të përmbushur nevojat e tregjeve vendore dhe rajonale të punës. **[RVV fq.12-13; Informacion për IAL-të në faqen e APAAL-it; M2; M3; M4; M5; M6] [Kapitulli III Standardi II.1]**
- 1.8 Zhvillimi social dhe ekonomik i Shqipërisë është një parim themelor i Strategjisë së Zhvillimit të Kolegjit dhe kolegji ka krijuar një rrjet partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, duke përfshirë bizneset vendore, organet publike dhe institucionet e arsimit të lartë. **[RVV fq.14-16; 5]** Krahas kësaj, kolegji ka nënshkruar 14 marrëveshje me biznese në mbarë Shqipërinë, për t'iu ofruar studentëve mundësinë që të zhvillojnë praktikën profesionale. Stafi akademik, përfaqësuesit e biznesit dhe ofruesit e vendeve të praktikës pohuan se organizatat vendore dhe rajonale, si dhe departamentet dhe programet kanë krijuar lidhje të forta. **[RVV fq.14-16; 24; 25]** Kjo, dhe kërkimi i tregut i ndërmarrë në nivel institucional, iu mundëson departamenteve dhe programeve të informohen rreth mundësive të zhvillimit ekonomik rajonal. **[RVV fq.14-16; AE11; AE12; AE13; AE26; M3; M4; M6]** Kolegji do të zhvillojë ceremoninë e parë të diplomimit të studentëve në qershor të vitit 2017. Qëllimi i tij është krijimi i një shoqate alumni, për të monitoruar punësimin e të diplomuarve të tij. **[RVV fq.15; M4; M5] [Kapitulli III Standardi III.1, Kapitulli III Standardi III.2, Kapitulli III Standardi III.3]**
- 1.9 Kolegji ka nënshkruar katër marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë, për të mbështetur stafin dhe për të ofruar mundësi mobiliteti për studentët. **[RVV fq.16; 22 (në gjuhën shqipe)]** Megjithatë, gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, as stafi dhe as studentët nuk morën pjesë, për arsye se kolegji e ushtronte veprimtarinë e tij për një periudhë të shkurtër. **[RVV fq.16]** Gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, kolegji nuk kishte punësuar staf akademik të huaj, si dhe asnjë student i huaj nuk ishte i regjistruar në programet e tij, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i sugjeron kolegjit ta trajtojë këtë çështje në një të ardhme të afërt. **[Informacion për IAL-në në faqen e APAAL-it; AE 16] [Kapitulli III Standardi III.4]**

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 KPT-ja ndjek politika të qarta për burimet njerëzore, që mbulojnë rekrutimin dhe punësimin e stafit dhe përmbushin kërkesat rregullatore. Politikat dhe procedurat në mënyrë të efektshme mbështesin dhe udhëheqin rekrutimin e një stafi të kualifikuar me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, për të përmbushur kërkesat akademike dhe administrative të kolegjit. **[RVV fq.18-19; 2; 6; 26; 28 (në gjuhën shqipe)]** Ka një strukturë organizative të qartë, e cila është e publikuar në faqen e internetit të kolegjit. **[10]** Stafi akademik rekrutohet sipas kërkesave, me qëllim plotësimin e ngarkesave mësimore të departamenteve, duke iu dhënë prioritet aplikantëve të kualifikuar nga institucionet Perëndimore. Kolegji pranon aplikime nga stafi gjatë gjithë vitit, por procesi i përzgjedhjes nis çdo vit në muajin shtator. **[RVV fq.18; 2; 6; 26; M4]** **[Kapitulli III Standardi IV.1, Kapitulli III Standardi II.2]**
- 2.2 Universiteti ka krijuar një ndjenjë komuniteti dhe integrimi midis stafit dhe studentëve të tij. **[RVV fq.19]** Stafi dhe studentët pohuan se pjesëmarrja në veprimtaritë e përbashkëta të organizuara në nivel qendror, duke përfshirë pjesëmarrjen në panairë pune, veprimtari sociale dhe konkurse sportive, i kanë ndihmuar që të integrohen plotësisht në komunitetin e kolegjit. **[RVV fq.19; 21 & 31 (në gjuhën shqipe); 32; M3; M4; M5]** Kolegji ka një kontratë për sigurimin e plotë të dëmshpërblimit, që iu ofron të gjithë studentëve të regjistruar mbulim të plotë për rastet e aksidenteve, kujdesin shëndetësor dhe diagnostikues, dhe të gjithë mbështetjen mjekësore të nevojshme. **[AE40; M4; M5]** Studentët i vlerësojnë shumë përfitimet që kanë nga mbulimi i plotë i sigurimeve shëndetësore, gjë që ekspertët e konsiderojnë si karakteristikë e praktikës së mirë. **[Kapitulli III Standardi IV.2, Kapitulli III Standardi IV.4]**
- 2.3 KPT-ja ka procedura të përshtatshme për vlerësimin e performancës së stafit të tij akademik. **[RVV fq.19-20; 2; 26]** Procesi i vlerësimit bazohet si në vlerësim të mënyrës së mësimdhënies gjatë vitit akademik nga menaxherët e linjës, ashtu edhe nga analiza e pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies. **[RVV fq.19-20; 33; M2; M3; M4; M5]** Stafi profesional i nivel të lartë pohoi se aktualisht po zhvillohet një proces vlerësimi për personelin administrativ. **[M4]** Kolegji i kushton rëndësi të madhe zhvillimit profesional të stafit akademik, si mënyrë për të siguruar cilësi në disiplinat profesionale. Për këtë arsye, konsulentë të jashtëm të kompanisë, që ka ofruar pajisjet për laboratorët dhe punishtet, zhvillojnë seanca trajnimi, me qëllim që studentët t'i vënë në praktikë njohuritë teorike të përftuara. **[RVV fq.19-20; 33; AE15; AE19]** **[Kapitulli III Standardi IV.3]**
- 2.4 Kolegji ka krijuar një sistem të efektshëm për menaxhimin financiar dhe gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor zbatohet ligji për arsimin e lartë dhe rregulloret e kolegjit. **[RVV fq.20-21; 2; AE27; M4]** Meqenëse kolegji është institucion privat i arsimit të lartë, Asambleja e Përgjithshme e KPT SHPK, një shoqëri tregtare që siguron qëndrueshmërinë financiare të kolegjit, duke miratuar çdo vit buxhetin e kolegjit. **[RVV fq.20-21; M4]** Buxhetet e departamenteve akademike, bazuar në numrin e studentëve që do të rekrutohen sipas marrëveshjes me Ministrinë, paraqiten për miratim të Administratori para se të shqyrtohen nga Asambleja e Përgjithshme. Zyra e Financës mbikëqyr zbatimin e buxhetit të miratuar. **[M4]** Stafi akademik i nivelit të lartë u shpreh se aplikimet për financim shtesë mund të bëhen te Zyra e Financës gjatë vitit akademik, në mënyrë që të kryhen blerje të mëdha në mbështetje të mësimdhënies. Departamentet administrative ndjekin të njëjtat rregulla si kolegët e tyre akademikë. **[M4; M8]** Për të qenë në përputhje me kërkesat rregullatore dhe ligjore, KPT-ja i nënshtrohet një sërë procesesh auditimi të brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë auditin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe auditin e Ministrisë. **[RVV fq.20; AE17]** **[Kapitulli III Standardi VI.2, Kapitulli III**

Standardi VI.3, Kapitulli III, Standardi VI.1]

- 2.5 KPT-ja ka një sistem të integruar informacioni të mbështetur në Politikat e Komunikimit. **[RVV fq.22-23; 38; 39; 40; 41; AE28; AE29]** Kolegji ka blerë një paketë softuerësh, për të menaxhuar informacionin e studentëve, e cila përfshin procesin e pranimit, materialet e mësimdhënies dhe mësimnxënies, librat elektronike, oraret e mësimin, informacionin e vlerësimit dhe shumë informacione lidhur me historikun e tyre në kolegji. Gjithashtu, sistemet e emailëve të studentëve dhe stafit janë integruar plotësisht me sistemin e informacionit, njësoj si portali i stafit akademik dhe mjedisi virtual i të nxënësve. Përdoruesit kanë akses në informacionet e tyre konfidenciale, duke përdorur fjalëkalime. Përpos kësaj, sistemi është krijuar për t'iu mundësuar stafit dhe studentëve aksesin në informacion nëpërmjet pajisjeve telefonike. **[RVV fq.22&23; 38, 39; 40; 41; AE28; AE29; M4; M8; Prezantimi i sistemit Classter]** Studentët dhe stafi u shprehën të kënaqur me kapacitetet e sistemit të integruar të menaxhimit të informacionit. **[M5; M7; M8]** Niveli i integritetit të sistemeve të informacionit të kolegjit, i arritur nëpërmjet kësaj pakete softuerësh, i cili iu mundëson stafit dhe studentëve akses në një mori informacionesh në një platformë të sigurt teknologjike, konsiderohet si karakteristikë e **praktikës së mirë**. **[Kapitulli III Standardi VII.1]**
- 2.6 Kolegji ka infrastrukturë të përshtatshme të teknologjisë së informacionit, e cila përbush nevojat e stafit dhe studentëve. Të gjitha ambientet e kolegjit mbulohen nga lidhja me Wi-Fi. Në ambientet e kolegjit ofrohen shumë laboratorë, të pajisur me mjete moderne të specializuara, për të mbështetur të nxënësve të studentëve. Krahas kësaj, sallat e leksioneve janë të pajisura me mjete moderne elektronike për mësimdhënien dhe në këto salla ka hapësira të përshtatshme kompjuterike, për të përbushur nevojat e mësimnxënies së studentëve. Gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, kolegji nuk ofron programe të të nxënësve në distancë. **[RVV fq.23; 41; turi për burimet e të nxënësve; M5; M8]** **[Kapitulli III Standardi VII.2]**
- 2.7 KPT-ja ka miratuar një Politikë të Menaxhimit të Pasurive që përcakton qartësisht rolet dhe përgjegjësitë e drejtuesve të lartë në lidhje me pasuritë e paluajtshme të kolegjit. **[RVV fq.23; 42; 43]** Kolegji ndodhet në katër katet e një ish-ndërtese industriale. Janë përgatitur plane për të zgjeruar ambientet e mësimdhënies brenda godinës aktuale dhe për të instaluar një ashensor, që iu mundëson studentëve me aftësi të kufizuara të lëvizshmërisë akses në të gjitha katet e kolegjit, duke qenë se gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, këta studentë kishin akses vetëm në katin e parë të godinës. **[M1; M2; M3; M4; M5; M8; Turi në burimet e të nxënësve]** Megjithatë kolegji aktualisht ofron ambiente dhe infrastrukturë, ku mund të zhvillohen veprimtaritë akademike dhe mund të mbështeten programet profesionale, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dhe një rekomandim për Fushë Vlerësimin "Studentët dhe Mbështetjen e tyre" që kampusi të bëhet plotësisht i aksesueshëm nga studentët me aftësi të kufizuara. **[Kapitulli III Standardi VII.3, Kapitulli III Standardi VII.5, Kapitulli III Standardi V.1]**
- 2.8 Duke qenë se Kolegji është një institucion relativisht i ri, ai nuk e ka zhvilluar plotësisht trashëgiminë dhe kulturën akademike dhe shkencore. **[RVV fq.24]** Megjithatë, KPT-ja siguron zhvillimin e kulturës së tij, duke i ruajtur syllabuset dhe literaturën përkatëse, për të gjitha programet e studimit, botimet dhe tekstet shkollorë të hartuara nga stafi akademik me kohë të plotë në bibliotekë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. **[RVV fq.24; AE37; AE38; M2; M3; M7; turi për burimet e të nxënësve]** **[Kapitulli III Standardi VII.4]**
- 2.9 Strategjia e Zhvillimit të Kolegjit është hartuar me qëllim që programet të vazhdojnë të ofrojnë një kurrikul bashkëkohorë, të orientuar drejt tregut. **[RVV fq.24-25; 5;**

AE18]Infrastruktura ekzistuese, stafi akademik me përvojë dhe i kualifikuar, laboratorët e pajisur me mjete moderne, dhe lidhjet e përshtatshme me tregun e punës garantojnë që të gjitha veprimtaritë e kolegjit të kryhen në mënyrë të efektshme. **[M1; M2; M3; M4; M5; M6; M7; M8; Turi për burimet e të nxëniet] [Kapitulli III Standardi VII.6]**

2.10 Kolegji i regjistron dhe i ruan të gjitha dokumentet zyrtare në përputhje me kërkesat ligjore. **[RVV fq.25-26; 43; AE30; AE31; AE32]** Sekretaria Mësimore, zyrat e Protokollit dhe Arkivës, dhe zyrat e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave kanë përgjegjësi të veçanta për ruajtjen e dokumentacioneve përkatëse në format elektronik dhe të shtypur. **[2; 44]** Sistemi i integruar i menaxhimit të informacionit të kolegjit përdoret që materialet të mbliidhen dhe të ruhen në mënyrë elektronike. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin e informacionit dhe, siç përcaktohet në pikën 2.5, kjo përfshin të dhënat personale për secilin student, që mund të aksesohen në një platformë të sigurt elektronike. **[39; AE28; AE29; M4; M8; prezantimi i sistemit Classter][Kapitulli III Standardi V.2]**

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- kontratat e sigurimit të plotë të dëmshpërblimit, që iu ofrohen të gjithë studentëve të regjistruar me mbulim të plotë të rasteve të aksidenteve, kujdesit shëndetësor dhe atij diagnostikues, dhe e gjithë mbështetja mjekësore e nevojshme (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.4**).
- niveli i integritetit të sistemeve të informacionit të kolegjit i arritur, nëpërmjet paketës së softuerëve, që iu mundëson stafit dhe studentëve akses në një sërë informacionesh në një platformë të sigurt teknologjike (pika 2.5; **Kapitulli III Standardi VII.1**).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 KPT-ja ofron nëntë programe të licencuara, me kohë të plotë, për marrjen e një diplome profesionale, me 120 kredite ECTS, siç përcaktohet në Statutin dhe rregulloret e tij.**[RVV fq.27; 2;6; informacione për IAL-në në faqen e APAAL-it; AE21; M1]**Pranimi në programe përcaktohet në Statut dhe rregullore, dhe ai ka një Politikë zyrtare Pranimi.**[RVV fq.39; 2;6;54]** Programet kanë kërkesat e tyre specifike të pranimit.**[RVV fq.28; 7]** Zyra e Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve menaxhon proceset e pranimit. **[RVV fq.39; 2; AE39; M4]** Politikat e Komunikimit përcaktojnë marrëveshjet për ofrimin e informacionit dhe organizimin e panairove dhe tureve.**[RVV fq.39; 38]** Në koordinim dhe bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale, KPT-ja angazhohet me shkollat e mesme, për të promovuar programet që ofron. **[RVV fq.27, fq.39; AE14]**Aktualisht, vetëm 9.5 për qind e studentëve janë studente.**[AE22][Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.2 Një nga prioritetet strategjike të KPT-së është zhvillimi i të nxënit gjatë gjithë jetës.**[5; M1]** Megjithatë, të gjitha programet janë aktualisht me kohë të plotë, megjithëse kolegji punon në partneritet me qëllim ofrimin e një certificate shtesë formimi.**[RVV fq.28; 52; AE21;Informacion për IAL-në në faqen e internetit të APAAL-it][Kapitulli I Standardi I.2]**
- 3.3 KPT-ja ka një Strategji të qartë dhe gjithëpërfshirëse Zhvillimi, që përcakton kontekstin për ofrimin aktual të programeve të studimit.**[RVV fq.29; 5]** Kolegji ka një mision të qartë për ofrimin e programeve profesionale, me qëllim përmbushjen e nevojave të punëdhënësve dhe të ekonomisë, dhe për më tepër stafi dhe punëdhënësit pohojnë se programet janë të bashkërenduara me tregun e punës.**[RVV fq.29; 2; AE11; AE18; Anketimi i APAAL-it për stafin; M1; M2; M3; M6]**Programet kanë synime dhe objektiva të mirëpërcaktuara, të cilat janë të kuptueshme nga studentët.**[RVV fq.28; 7;53; M5] [Kapitulli I Standardi I.3]**
- 3.4 Strategjia e Zhvillimit e KPT-së synon të përmbushë nevojat e bizneseve dhe të ekonomisë.**[RVV fq.29; 5]** KPT-ja bashkëpunon me forume dhe për një sërë veprimtarish me IAL të tjera, dhe stafi i pohon këto bashkëpunime.**[RVV fq.29; 22; Anketimi i APAAL-it për stafin; AE12; M1; M3]**Aktualisht, KPT-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me 14 punëdhënës. **[25; M1; M2; M3; M6]** Lënda e gjuhës angleze zhvillohet në vitin e parë.**[RVV fq.29; AE21][Kapitulli I Standardi I.4]**
- 3.5 KPT-ja ka infrastrukturën e nevojshme për të ofruar programet e tij,**[RVV fq.29; 43; 41;59; M1; M4; M5]**dhe ka punësuar 23 pedagogë me kohë të plotë dhe 11 pedagogë me kohë të pjesshme, të cilët janë me përvojë, dhe pothuajse të gjithë kanë kryer kualifikime pasuniversitare. Pjesë e stafit janë edhe punonjës të sektorit të industrisë, dhe persona që kanë punuar jashtë vendit.**[1;62; Anketimi i APAAL-it për stafin; M1; M2]** Kolegji gjithashtu ka punësuar teknikë për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe punishteve.**[Turi në burimet e të nxënit]** KPT-ja përcakton qartësisht objektivat për stafin akademik, nëpërmjet një kontrate me shkrim, si edhe pritshmëritë që stafi të marrë pjesë në një sërë veprimtarish zhvillimi.**[RVV fq.30; 30; 52; AE19; Anketimi i APAAL-it për stafin][Kapitulli I Standardi I.5]**
- 3.6 Senati mbikëqyr programet e studimit.**[2;6]** Njësitë dhe kreditet për secilin program përcaktohen qartë dhe janë të kuptueshme për studentët.**[46;47; AE21; M5]** Kolegji përdor një sistem të integruar për menaxhimin e informacionit, me anë të të cilit komunikon me studentët, dhe këta të fundit pohuan se ai funksionon në mënyrë të efektshme.**[AE28 & 29; M5]** Kriteret e pranimit janë të dokumentuara qartësisht. **[RVV fq.30; 54][Kapitulli I Standardi I.6]**

- 3.7 Kolegji aktualisht ofron vetëm programe dyvjeçare me diplomë profesionale, që janë hartuar për t'i përgatitur të diplomuarit për tregun e punës ose për studime të mëtejshme, por deri më sot nuk ka asnjë të diplomuar. **[RVV fq.27, 30; 2;6; informacione për IAL-në në faqen e APAAL-it; AE21; M1; M2]** Programet iu ofrojnë studentëve njohuri bazë në metoda dhe parime shkencore, dhe përfshijnë edhe vendet ku do të kryhet praktika profesionale. **[RVV fq.30; 8;51;53;46;47;M5]** Studentët kanë akses në laboratorë të ndryshëm, dhe si studentët, ashtu edhe stafi u shprehën se janë të kënaqur me ambientet. **[35;41;43;59; Anketimi i APAAL-it për studentët; Anketimi i APAAL-it për stafin; M5]** Krahas këtyre, ofrohen edhe mundësi për transferimin e studentëve dhe kjo bëhet e ditur në manualin e studentëve. **[RVV fq.31; 6;55; 64]** Punëdhënësit dhe studentët u shprehën me bindje për mundësitë e punësimit të të diplomuarve nga ky kolegji. **[M5; M6][Kapitulli I Standardi I.7]**
- 3.8 Zyra e Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentëve. **[RVV fq.31; 2; 6;AE50]** Ka një rregullore të qartë për tutorimin dhe këshillimin akademik, dhe studentët një orë në javë kanë mundësi të bisedojnë me tutorin e tyre. Studentët raportojnë se stafi është shumë i disponueshëm dhe ofron këshillim të standardit të lartë. **[RVV fq.31;56;67; Anketimi i APAAL-t për studentët; M5]** Kurrikulat përfshijnë një ndërthurje të teorisë dhe praktikës, duke përfshirë të nxënit në laborator, dhe studentët besojnë se ekuilibri midis teorisë dhe praktikës është i përshtatshëm. **[46;47;53; M2; M5]** Stafi i punësuar nga kolegji është një ndërthurje e akademikëve me përvojë dhe specialistëve teknikë. **[M1; M3]** Të paktën 80 për qind e orëve mësimore zhvillohen nga stafi akademik me kohë të plotë. **[RVV fq.31; 57][Kapitulli I Standardi I.8]**
- 3.9 Kapitulli 1, Standardi 1.9 nuk është i disponueshëm. **[Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.10 Programet janë me kohë të plotë, përputhen me Procesin e Bolonjës dhe përcaktohen në rregulloret e kolegjit. Kurrikulat janë të ndara në module dhe kreditet përcaktohen sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. **[RVV fq.32; 2;6;51; 53; M1]** Lënda e gjuha angleze është pjesë e kurrikulës. **[RVV fq.32;46;47; AE21; M2]** Kolegji ka për qëllim përfshirjen në programin e Erasmus+ dhe ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me një universitet grek, për të vendosur bashkëpunim ndërkombëtar, duke përfshirë mobilitetin e stafit dhe studentëve. **[24; M1; M6]** Janë nisur procedurat për transferimin e studentëve. **[RVV fq.31; 55]** Kolegji nuk lëshon ende diploma për të diplomuarit e tij, por këtë gjë do ta bëjë Sekretaria Mësimore. **[M1; M8][Kapitulli I Standardi I.10]**
- 3.11 Programet iu ofrojnë studentëve njohuri bazë, metoda dhe parime shkencore, dhe në këtë mënyrë studentët gradualisht përvetësojnë aftësi teknike dhe profesionale, dhe në vitin e dytë zhvillojnë praktikën profesionale. **[RVV fq.30; 8;51; 53;46;47; M1; M2; M5; M6]** Studentët kanë akses në laboratorë me standarde industriale dhe shprehen se janë të kënaqur me ambientet. **[41; 43; 59; Anketimi i APAAL-it për studentët; M6]** Krahas kësaj, studentët nxiten të marrin pjesë në shumë veprimtari të vlefshme, duke përfshirë Klubin e Novacionit, printimin 3D, dhe Drone. **[RVV fq.32; 58;52; <http://kolegjiprofesional.edu.al/web/?lang=en> vizituar më 08.04.17]** KPT-ja i nxit studentët të marrin pjesë në jetën institucionale **[RVV fq.31; 58;68]** dhe ofron mundësi që stafi dhe studentët të përfshihen në veprimtari sociale të përbashkëta, si kampionate futbollit ose udhëtime. **[RVV fq.31; 32; M4; M5][Kapitulli I Standardi I.11]**
- 3.12 Kolegji ka një mision të qartë për ofrimin e programeve profesionale që të përmbushë nevojat e punëdhënësve dhe të ekonomisë në Shqipëri. **[RVV fq.29; 2;**

M1; M2]Strategjia e Zhvillimit e KPT-së synon përmbushjen e nevojave të biznesit dhe ekonomisë.**[RVV fq.29; 5; AE11]** Studentët zhvillojnë një larmi aftësish dhe shprehish për punë, nëpërmjet praktikës profesionale, që është pjesë e detyrueshme e programit. **[RVV fq.33; 6;8; M2; M7]**Studentët e kanë mundësinë të punojnë drejtpërdrejt në sektorin e industrisë në një sërë projektesh **[Turi në burimet e të nxënit]**.Kurrikula zhvillon aftësi teknike dhe profesionale, duke zbatuar teorinë me anë të praktikës dhe simulimit, dhe duke i vënë ato në praktikë në laboratorë e më pas në punishte, dhe duke i përforcuar ato në institucionet, ku zhvillojnë praktikën profesionale, dhe stafi akademik e vërteton novacionin e ofruar nga kolegji, nëpërmjet kësaj kurrikule të mbështetur në praktikë, e cila përmbush nevojat e sektorit të industrisë dhe të diplomuarve. **[M5; M6; M7; Turi në burimet e të nxënit]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë si **praktikë të mirë**. Ambientet laboratorike të kolegjit iu ofrojnë studentëve burimet e nevojshme për zhvillimin e aftësive teknike dhe profesionale.**[59; M5; M6; M7; Turi në burimet e të nxënit]** Aktualisht, KPT-ja ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 14 punëdhënës dhe stafi pohon se ka marrëdhënie të shkëlqyera me tregun e punës dhe punëdhënësit.**[25; Anketimi i APAAL-it për stafin; M1; M2; M6]** Studentët kanë besim në aftësitë e tyre për punësim, të cilat po i zhvillojnë në këtë kolegji dhe shprehen optimistë për mundësitë e punësimit në të ardhmen.**[M5]** Zyra e Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve luan rol të rëndësishëm në këshillimin e karrierës, dhe studentët shprehen të kënaqur me shërbimet dhe informacionin e ofruar.**[RVV fq.31; 2;6; Anketimi i APAAL-it për studentët]** Ata u shprehen se janë të kënaqur me aftësitë që kanë zhvilluar.**[Anketimi i APAAL-it për studentët; M5] [Kapitulli I Standardi I.12]**

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë.

- ofrimi i kurrikulave novatore mbështetur në praktikë, që përmbushin nevojat e sektorit të industrisë dhe të diplomuarve(pika 3.12; **Kapitulli I Standardi I.12**).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Ka mekanizma për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve të mësimdhënies me qëllim përmbushjen e standardeve të cilësisë. Programet që ofron kolegji janë të disponueshme në format të shtypur dhe elektronik në faqen e internetit. **[RVV fq.34; 2; 6; 46; 47; Faqja e internetit: <http://kolegjiprofesional.edu.al/web/teknologji-informacioni-dhe-komunikimi/?lang=en>]** Departamentet janë përgjegjëse për menaxhimin efikas të programeve, duke hartuar syllabuse, oraret e semestrit, dhe pyetjet e provimeve. **[RVV fq.34; 2; 6]** Kolegji ka shumë laboratorë dhe punishte cilësore, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë si **praktikë të mirë**, duke qenë se mbështet zbatimin e kësaj kurrikule. Studentët gjithashtu zhvillojnë praktikën profesionale në fund të programit. **[RVV fq.34; 59; Turi në burimet e të nxënit; M5; M6; M7; M8]** Programet e studimit përmirësohen vazhdimisht, nëpërmjet një procesi rishikimi vjetor, i cili përfshin rishikimin e secilit program, duke marrë parasysh studimin e tregut. **[RVV fq.34; 18; AE11, M1; M2] [Kapitulli I Standardi II.1]**
- 4.2 Kërkesat dhe rregulloret e vlerësimit përcaktohen në Statut dhe rregulloret akademike sipas standardeve të cilësisë. **[RVV fq.35; 2, 6; M1; M2]** Përgjegjësit e departamenteve miratojnë pyetjet e provimeve, sekretarët mësimorë mbajnë rezultatet e provimeve dhe profilet e arritjeve të studentëve, dhe ato iu vihen në dispozicion studentëve, nëpërmjet një sistemi konfidencial online. Rregulloret përcaktojnë se studentët kanë të drejtën e ankimit të përgjegjësi i departamentit, i cili ngre një komision prej tre personash, që do të shqyrtojë posaçërisht këtë çështje. Studentët u shprehën pozitivisht për feedback-un që marrin për rezultatet e tyre në provime. **[RVV fq.35; 6; 7; 53; 60; M5; M8] [Kapitulli I Standardi II.2]**
- 4.3 Procedurat që ndjek KPT-ja për kryerjen e vlerësimit dhe monitorimit të proceseve të mësimdhënies, janë në përputhje me Statutin e saj dhe zbatohen nën kujdesin e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë. Këto procedura përfshijnë: vlerësimin e studentëve, vlerësimin e mësimdhënies, pyetësorë dhe analizën e performancës së studentëve. **[RVV fq.35; 2;6; 15;61; M1; M5]** Në fund të çdo semestri, studentët plotësojnë një pyetësor për mendimin e tyre lidhur me programin. Të dhënat për secilin program analizohen dhe shqyrtohen në nivel departamenti dhe Senati. **[RVV fq.35; 2; 6; 61; M2]** Gjatë vlerësimit të jashtëm, studentët pranuan se ndryshimet dhe përmirësimet në ofrimin e mësimdhënies pasqyronin feedback-un që kishin dhënë në pyetësorë. **[33; M2; M5; M7; M8][Kapitulli I Standardi II.3]**
- 4.4 Njësia e Sigurimit të Cilësisë vëzhgon mësimdhënien dhe përgatit një raport vlerësimi në bazë të të dhënave të mbledhura, nëpërmjet anketimeve, vëzhgimit nga kolegët dhe vëzhgimit nga përgjegjësi i departamentit. Raportet më pas shqyrtohen nga përgjegjësi i departamentit përkatës, i cili përgatit një përmbledhje të vlerësimit dhe përcakton objektivat për vitin akademik pasardhës. **[RVV fq.35; 13; 15; M2; M7]** Krahas kësaj, ngarkesa e stafit rishikohet vazhdimisht. **[57; M7][Kapitulli I Standardi II.4]**
- 4.5 KPT-ja ofron kualifikime të nivelit të pestë, duke u përqendruar në përgatitjen e profesionistëve dhe specialistëve me titullin "Teknik". Për këtë arsye, kërkimi shkencor i mirëfilltë nuk është pjesë e politikave. **[RVV fq.38]** Megjithatë, kolegji i përkushtohet kërkimit kundrejt objektivave të tij, të përcaktuara në Statut, dhe kërkimi dhe përkushtimi ndaj rritjes së kapacitetit të stafit janë pjesë e nismave të ndërmarra nga marrëveshjet dypalëshe me IAL-të e tjera. **[RVV fq.37; 2, AE12]** Kolegji po punon për të krijuar kontakte me partnerë akademikë, me qëllim

bashkëpunimin me ta dhe pjesëmarrjen në programet Erasmus Mundus, të cilat mbështesin veprimtaritë kërkimore, mobilitetin e stafit dhe të studentëve. **[M1; M3; M7][Kapitulli II Standardi I.1 – I.8]**

- 4.6 Duke qenë se kolegji ofron kualifikime të nivelit të pestë për specialistë teknikë dhe duke pranuar se kërkimi shkencor nuk është pjesë e politikave të KPT-së, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm del në përfundimin se Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë.

- laboratorë dhe punishte cilësore për ta mbështetur zbatimin e kurrikulës (pika 4.1; ***Kapitulli I Standardi II.1***).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Pranimi i studentëve në programe menaxhohet në përputhje me rregulloret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, siç përcaktohen në Statut dhe në rregulloret e kolegjit. Kërkesat e pranimit përcaktohen qartë në Politikën e Pranimit.[RVV fq.39; 2; 5;6;54]Rritja e planifikuar i numrit të studentëve është në përputhje me numrin e stafit dhe burimet e tjera [M1; M8; Turi në burimet e të nxënimit].Faqja e internetit përmban informacione për studentët e mundshëm dhe palë të tjera interesi.[<http://kolegjiprofesional.edu.al/web/teknologji-informacioni-i-pergjithshem/>]Pranimet menaxhohen nga Zyra e Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, që koordinon zyrat e marketingut dhe komunikimit në përputhje me Politikën e Komunikimit, si edhe turet dhe mbledhjet në terren.[RVV fq.39; 21;31; 38; 50; AE39] Aktualisht sistemet e zhvilluara i mundësojnë kolegjit të monitorojë nivelin e interesit në secilin program, duke përfshirë nivelet e veprimtarive të lidhura me informacionin në faqen e internetit, aplikimet ose vizitat në kampus[M8].Studentët u shprehën se informacioni që kishin marrë ishte i qartë dhe i saktë, dhe se në fillim të studimeve të tyre iu ishte ofruar orientim i mjaftueshëm.[M5][Kapitulli I Standardi III.1]
- 5.2 Kolegji ka një paketë softuerësh për menaxhimin e informacioneve të brendshme të studentëve dhe stafit, duke përfshirë procesin e pranimeve. Gjithashtu, sistemet e emailleve të studentëve dhe stafit janë të integruar plotësisht me sistemin. Përdoruesit kanë akses në të dhënat e tyre konfidenciale, duke përdorur fjalëkalime në përputhje me Politikën e Internetit.[RVV fq.41; 38;63; AE28; M4; M8; Prezantimi i sistemit Classter]Të dhënat personale të studentëve ruhen në regjistrin themeltar.[RVV fq.46; 45][Kapitulli I Standardi III.2]
- 5.3 Kolegji ka Zyrën e Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve si strukturë për ofrimin e informacionit dhe këshillimit ndaj studentëve. Kjo zyrë ofron informacione për kriteret e pranimit dhe gjithashtu i drejton studentët te zyrat e departamentit dhe zyra të tjera mbështetëse.[RVV fq.39; Turi në burimet e të nxënimit]Studentëve iu është ofruar një manual gjithëpërfshirës dhe ata i pohuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se kanë marrë informacione të hollësishme për syllabusin dhe ishin shumë të qartë për detyrimet financiare para se të regjistroheshin.[RVV fq.42; 64; M5]Rregulloret përcaktojnë planet për transferimin e studentëve dhe kjo komunikohet në manualin e studentëve.[6; 64][Kapitulli I Standardi III.3]
- 5.4 Kolegji ka një politikë të qartë dhe gjithëpërfshirëse për mbështetjen e studentëve nga grupet e identifikuara, nëpërmjet kuadrove të përcaktuara në Statut dhe Rregulloret për studentët me aftësi të kufizuara.[RVV fq.42; 2; 65]Kolegji ka krijuar një skemë për bursat e arritjeve.[RVV fq.42; 66] Aktualisht, duke qenë se mësimdhënia zhvillohet në katet e sipërme dhe nuk ka ashensor, ambientet nuk janë të aksesueshme nga studentët me aftësi të kufizuara. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pranon se gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit, stafi u shpreh se do të merreshin masat e duhura për përmbushjen e nevojave të studentëve me aftësi të kufizuara. Pavarësisht kësaj, grupi e konsideron si **dobësi** aksesin e kufizuar në ambientet e mësimdhënies dhe për këtë arsye **rekomandon** që kolegji të marrë masa për ta bërë kampusin plotësisht të aksesueshëm nga studentët me aftësi të kufizuara.[Turi në burimet e të nxënimit; M2; M8][Kapitulli I Standardi III.4]
- 5.5 Kolegji po krijon një bibliotekë në kampus dhe ka caktuar një buxhet për këtë.[RVV fq.43; 43; FE2]Gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, stafi pranoi se fondi i bibliotekës duhet pasuruar, duke qenë se shumë tekste ishin për programet e studimeve të nivelit Bachelor. Zakonisht, pedagogët përdorin librat e tyre për të zhvilluar orët mësimore ose janë përkthejnë ekstrakte nga librat në gjuhën angleze,

për t'i përmbushur nevojat e studentëve të tyre. [M2; M4; M7; M8] Studentët u shprehën se biblioteka po pasurohet dhe në rast se ata kërkojnë libra, iu mundësohen shumë shpejt. Oraret e hapjes janë të qarta dhe studentët mund të marrin libra dhe t'i mbajnë deri në tre ditë. [M5] Shumica e librave ruhen në mënyrë elektronike, dhe janë të aksesueshme nëpërmjet sistemit të integruar online, që është identifikuar si karakteristikë e praktikës së mirë në Fushën e Vlerësimit 2. [RVV fq.43; M5; M8; Prezantimi i sistemit Classter] Megjithatë, kolegji nuk vuri në dispozicion një plani të qartë strategjik për zhvillimin e bibliotekës. [M2; M3; M7; M8] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si **dobësi** literaturën aktuale që iu ofrohet studentëve në format elektronik dhe të shtypur. **Rekomandohet** që kolegji të hartojë dhe të zbatojë një plan për zhvillimin e bibliotekës, që të sigurohet ofrimi i literaturës së mjaftueshme në format të shtypur dhe elektronik. [Kapitulli I Standardi III.5]

- 5.6 Studentëve iu ofrohet mjaftueshëm mbështetje. Tutorimi dhe këshillimi akademik përcaktohen në rregullore. [RVV fq.43; 6; 56] Studentëve iu ofrohet një manual, [64] si dhe kanë mundësinë që një orë në javë të diskutojnë me tutorin e tyre, dhe ata janë të mendimit se ky është një element pozitive. Në dosjen e tutorimit mbahet një procesverbal i mbledhjes. [67; M5] Aksesi në informacione të detajuara për programet, nëpërmjet intranetit, si edhe në shënime dhe materiale të kurseve. [Prezantimi i sistemit Classter] Për të siguruar mbështetje të mjaftueshme akademike, kolegji i përmbahet kërkesave statutoire për raportin 1:8 staf-studentë. [RVV fq.40] [Kapitulli I Standardi III.6]
- 5.7 Këshilli Studentor i formuar së fundmi, që përbëhet nga përfaqësues të studentëve, dhe zgjidhet çdo vit nga studentët, ofron feedback në emër të trupës studentore. [RVV fq.44; 2; 6; 68] Përfaqësuesit e tij shërbejnë në Senatën Akademik, Bordin e Etikës, Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, dhe në mbledhjet me organet drejtuese të KPT-së. [RVV fq.44; 2; 68; 69] Këshilli Studentor e zgjodhi përfaqësuesin e studentëve në Grupin e Vetëvlerësimit. [M2] Këshilli Studentor mblidhet çdo javë për të diskutuar çështje të ndryshme ose për të planifikuar veprimtari sociale. [69; M5] Studentët dhe stafi u shprehën se ishin zhvilluar veprimtari sociale, siç janë kampionatet e futbollit. [M3; M5] Megjithatë, ata pranuan se Këshilli Studentor nuk kishte akses në burimet e tij financiare dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë si **dobësi**. **Rekomandohet** që kolegji t'i alokojë Këshillit Studentor burimet financiare. [M3; M5] [Kapitulli I Standardi III.7]
- 5.8 KPT-ja iu ofron studentëve të tij veprimtari sportive dhe sociale, duke përfshirë kampionatin e futbollit dhe aktivitetet sociale. [RVV fq.45; 32; M3; M5] Studentët gjithashtu angazhohen në veprimtari të lidhura me kurrikulën, si Klubi i Inovacionit, Printimi 3D dhe Drone. Klubi i Inovacionit po mbështet zhvillimin e sistemit të integruar të komunikimit online. [RVV fq.45; 58; Turi në burimet e të nxënit; M8] [Kapitulli I Standardi III.8]
- 5.9 Kolegji ka një mision të qartë për ofrimin e programeve profesionale, me qëllim përmbushjen e nevojave të punëdhënësve dhe të ekonomisë, si dhe stafi dhe punëdhënësit pohojnë se programet janë të bashkërenduara me tregun e punës. [RVV fq.29; 2; AE11; AE18; Anketimi i APAAL-it për stafin; M1; M2; M3; 6] Megjithëse nuk është diplomuar ende asnjë student, studentët dhe punëdhënësit kanë besim se të diplomuarit e këtij kolegji do të kenë aftësitë dhe njohuritë e kërkuara për t'u punësuar menjëherë. [M5; M6] Aktualisht, Zyra e Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve luan rol në mbështetjen e studentëve për gjetjen e vendit të punës dhe ka plane për hapjen e Zyrës së Karrierës në një të ardhme të afërt. [RVV fq.46; AE39; M3; M4; M8] [Kapitulli I Standardi III.9]

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- akses i kufizuar në të gjitha godinat e mësimdhënies për studentët me aftësi të kufizuara (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.4**)
- literatura aktuale që iu ofrohet studentëve në format të shtypur dhe elektronik në bibliotekë (pika 5.5; **Kapitulli I Standardi III.5**)
- Këshilli Studentor nuk ka akses në burimet e tij financiare (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- kampusi të bëhet plotësisht i aksesueshëm për studentët me aftësi të kufizuara (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.4**)
- të hartohet dhe të zbatohet një plan për zhvillimin e bibliotekës, që të sigurohet ofrimi i literaturës së mjaftueshme në format të shtypur dhe elektronik (pika 5.5; **Kapitulli I Standardi III.5**)
- Këshillit Studentor t'i alokohen burime financiare (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Lista e dokumenteve

RVV

Renditja	Nr. i dokumentit	Titulli
1		Të dhëna të përgjithshme
2		Vërtetim autenticiteti nga Rektori
3		Raporti i Vetëvlerësimit
4	1	Autorizimi i Grupit të Vetëvlerësimit
5	2	Statuti i Kolegjit Profesional
6	3	Në gjuhën shqipe
7	4	Urdhër Nr. 426, datë 06.11.16 - Në gjuhën shqipe
8	5	Strategjia e Zhvillimit
9	6	Rregulloret e KPT-së
10	7	Rregullorja e Elektronikës
11	8	Rregullorja e Praktikës Profesionale
12	9	Vendimi i Senatit Akademik
13	10	Struktura organizative
14	11	MM-të dhe Vendimet e Mbledhjeve - Në gjuhën shqipe
15	12	Dalja në pension dhe emërimi i një anëtari të Senatit
16	13	Raporti i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) për Programet 2016/17
17	14	Urdhri i NjSBC-së - Në gjuhën shqipe
18	15	Raporti i NjSBC-së për procedurat e provimeve 2015/16
19	16	Regjistrimi në Shërbimin e Bashkimit Evropian të Autenticitetit
20	17	Miratimi i Strategjisë së Zhvillimit 2015-2020 nga Senati
21	18	Statistika - Në gjuhën shqipe
22	19,1 & 19,2	Dosja e TEI - Në gjuhën shqipe
23	20	Komunikimi me Balfin Group - Në gjuhën shqipe
24	21	Panaire - Në gjuhën shqipe
25	22	Lista e Marrëveshjeve me IAL-të - Në gjuhën shqipe
26	23	Konferencë - Në gjuhën shqipe
27	24	MM me Universitetin e Thesalisë 1.3.17
28	25	Lista e marrëveshjeve me bizneset
29	26	Manuali i Burimeve Njerëzore
30	27	Kërkesa e Kancelarit për Koordinatorët e të nxënit
31	28	Procesi i rekrutimit - Në gjuhën shqipe
66	29	Screensaver-i i faqes së mëparshme (cilësi e dobët)
33	30	Kontratat e stafit - Akademikët, akademikët e jashtëm dhe administratori
74	31	Ture - Në gjuhën shqipe
67	32	Veprimtari sociale për stafin
34	33	Formularë vlerësimi për studentët
35	34	Dosja e stafit - Në gjuhën shqipe
36	35	Dosja e laboratorit
37	36	Kodi i Etikës
38	37	Rezoluta e Asamblesë - Në gjuhën shqipe
39	38	Politika e Komunikimit
68	39	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Studentëve
40	40	Procedurat për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Faqes së Internetit
41	41	Infrastruktura e TI-së

42	42	Politika e Menaxhimit të Pasurive
43	43	Informacione për Menaxhimin e Infrastrukturës dhe Pasurive, duke përfshirë Bibliotekën
69	44	Fotokopje e regjistrit të notave
70	45	Fotokopje e regjistrit themeltar
44	46	Diplomë profesionale në planin mësimor të Elektronikës
45	47	Diplomë profesionale në planin mësimor të Teknologjisë së Ajrimit dhe Kondicionimit
46	48	Broshurë promovuese - Në gjuhën shqipe
47	49	Copëza gazete - Në gjuhën shqipe
48	50	Drejtoria e Arsimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit - Në gjuhën shqipe
49	51	Elektronikë - Modulet dhe orët mësimore
71	52	Informacion për Trajnimet e ofruara nga Ministria e Mjedisit
50	53	Syllabusi elektronik
51	54	Kriteret dhe politika e pranimeve
52	55	Rregulloret e transferimit
53	56	Rregulloret për tutorimin dhe këshillimin akademik
72	57	Ngarkesat e mësimdhënies së stafit
73	58	Aktivitet ekstrakurrikular - Klubi i Novacionit, Printimi 3D, Drone
54	59	Përshkrime të hollësishme të laboratorëve
55	60	Emaille për provimet - Në gjuhën shqipe
56	61	Përmbledhje e vlerësimeve të studentëve për performancën e stafit
57	62	CV-të e stafit
58	63	Politika e Komunikimit
59	64	Manuali i studentëve
60	65	Rregulloret për mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara
61	66	Bursat për arritje
62	67	Dosja e tutorimit - Në gjuhën shqipe
63	68	Votimi për Këshillin Studentor - Në gjuhën shqipe
64	69	MM i mbledhjes - Në gjuhën shqipe
65	70	Pjesëmarrja në një konferencë - Në gjuhën shqipe

Dokumente shtesë (AE)

Renditja	Nr. i dokumentit	Titulli
1		Përgjigja ndaj kërkesave për dokumente shtesë
2	AE 1	Zinxhiri i raportimit në KPT - Në gjuhën shqipe
3	AE 1	Zinxhiri i raportimit në KPT
4	AE 2	Dokumente të vendimeve të Senatit Akademik
5	AE 2	Dokumente të vendimeve të Senatit Akademik të nënshkruara (Kopje) - Në gjuhën shqipe
6	AE 3	Anëtarët dhe procesverbali i Senatit Akademik
7	AE 3	Anëtarët dhe procesverbali i Senatit Akademik (Kopje) - Në gjuhën shqipe
8	AE 4	Procesverbali i Rektoratit
9	AE 4	Procesverbali i Rektoratit (Kopje) - Në gjuhën shqipe
10	AE 5	Procesverbali i Këshillit të Etikës
11	AE 6	Procesverbali i Asamblesë së Përgjithshme
12	AE 6	Procesverbali i Asamblesë së Përgjithshme (Kopje) - Në

		gjuhën shqipe
13	AE 7	Vështrim i Përgjithshëm i Marrëveshjeve të Menaxhimit
14	AE 8	Raporti Vjetor 2015-2016
15	AE 9	Të dhënat e stafit dhe studentëve 2016-2017
16	AE 9	Të dhënat e stafit dhe studentëve 2016-2017 (Kopje) - Në gjuhën shqipe
17	AE 10	Përmbledhja organizative dhe procesverbali i mbledhjeve të Senatit dhe Rektoratit
18	AE 11	Kërkim i tregut
19	AE 11	Kërkim i tregut (Kopje) - Në gjuhën shqipe
20	AE 12	Dokumente të bashkëpunimeve
21	AE 12	Dokumente të bashkëpunimeve (Kopje) - Në gjuhën shqipe
22	AE 13	Informacion për Trajnimet e ofruara nga Ministria e Mjedisit (Kopja 52 në dokumentin RVV)
23	AE 14	Dita e informimit për shkollat e mesme
24	AE 15	Dita e Zhvillimit të stafit, e realizuar nga Polytech SA lidhur me Teknikat dhe Mjetet Laboratorike
25	AE 16	Deklaratë për mungesën e punësimit të stafit akademik të huaj
26	AE 17	Auditimi dhe inventari i asetëve afatgjata 2016
27	AE 18	Deklaratë për Orientimin e Kurrikulave në Treg
28	AE 19	Formimi i trajnuesve për mjetet laboratorike - vështrim i përgjithshëm
29	AE 20	Procesverbali i Këshillit Studentor, shkurt 2017
30	AE 21	Programet dhe modulet/kreditit
31	AE 22	Ndarja sipas gjinive - Stafit dhe studentët
32	AE 23	Dokumente mbështetëse për Raportet Vjetore (Pranimi i studentëve, performanca e studentëve, përputhshmëria me rregulloret)
33	AE 24	Dokumente të vlerësimit të Programeve dhe Raporteve të Departamenteve, në nivel departamenti dhe institucioni
34	AE 24	Dokumente të vlerësimit të Programeve dhe Raporteve të Departamenteve, në nivel departamenti dhe institucioni (Kopje) - Në gjuhën shqipe
35	AE 25	Raporti i vëzhgimit të mësimdhënies
36	AE 26	Informacion për Marrëveshjet e Bashkëpunimit për të mbështetur institucionet, ku zhvillohet praktika profesionale
37	AE 27	Rregullat dhe standardet për menaxhimin financiar
38	AE 28	Sistemi i IT-së Classter për stafin dhe studentët
39	AE 29	Përdorimit i sistemit të IT-së Classter, për ndarjen e planeve dhe burimeve të mësimdhënies
40	AE 30	Roli i koordinatoreve akademikë në mirëmbajtjen e një arkivi në format elektronik dhe të shtypur të programeve dhe planeve të mësimdhënies
41	AE 31	Informacion për Ruajtjen e Dokumenteve Elektronike dhe përdorimin e SharePoint
42	AE 32	Informacion për Ruajtjen e Dokumenteve Elektronike dhe përdorimin e SharePoint
43	AE 33	Deklaratë për Zhvillimin e Stafit
44	AE 34	Dokumente të publikimit të orareve dhe programeve në faqen e internetit
45	AE 35	Raporti i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) për Programet 2016/17 (Kopje e Dokumentit RVV 13)
46	AE 36	Deklaratë për Kërkimin

47	AE 36	Deklaratë për Kërkimin (Kopje) - Në gjuhën shqipe
48	AE 37	Materiale online në gjuhë të tjera të disponueshme nëpërmjet SharePoint-it
49	AE 38	Deklaratë për Bibliotekën dhe Katalogun e saj
50	39	Dokumente të punës në Zyrën e Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve
51	40	Kontrata e Sigurimit të Dëmshpërblimit

Dokumente shtesë (FE)

Renditja	Nr. i dokumentit	Titulli
1	FE1	Mbledhja me pjesëmarrësit
2	FE2	Buxheti

Mbledhjet (Mx)

M1	Mbledhja 1
M2	Mbledhja 2
M3	Mbledhja 3
M4	Mbledhja 4
M5	Mbledhja 5
M6	Mbledhja 6
M7	Mbledhja 7
M8	Mbledhja 8